

Deklaratë për shtyp: Themelohet Dhoma Zgjedhore në Shqipëri

Skaner vendor për zgjedhjet

Organizatave e shoqërisë civile në vend, bashkohen për të reaguar me një zë të vetëm për ecurinë dhe sfidat e procesit zgjedhor në Shqipëri

Shtatë organizata jo qeveritare, do të koordinojnë informacionet dhe ekspertizën e tyre lidhur me ecurinë e zgjedhjeve lokale 2015!

Dhoma Zgjedhore, sjell bashkë, për herë të parë në Shqipëri, aktorët kryesorë vendas të angazhuar drejtpërsëdrejti ose indirekt me procesin zgjedhor.

Dhoma Zgjedhore, është një platformë koordinimi e përfaqësuesve të shoqërisë civile që mbledhen periodikisht gjatë periudhës së zgjedhjeve për të analizuar informacionin që vjen nga terreni, japin paralajmërime për probleme të mundshme dhe bëjnë rekomandime të menjëhershme për të siguruar besueshmërinë dhe suksesin e procesit zgjedhor.

Dhoma Zgjedhore synon fuqizimin e bashkëpunimit mes aktorëve të shoqërisë civile me fusha të ndryshme ekspertize lidhur me zgjedhjet. Dhoma Zgjedhore do të mbështetet në përvojën më të mirë të krijuar deri tani nga monitorimi vendas i proceseve zgjedhore. Por ajo do t'i japë të tjera dimensione këtij roli të rëndësishëm, duke qenë një zë i besueshëm dhe shumë serioz vendas për dhënien e vlerësimeve mbi cilësinë e proceseve zgjedhore, jo vetëm vendore.

Dhoma zgjedhore do të jetë një strukturë e pavarur, tërësisht shqiptare, por e hapur dhe koordinuese me cdo aktor e faktor tjetër, vendas e të huaj, për të shkëmbyer informacion dhe ekspertizë lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e proceseve zgjedhore.

Dhoma zgjedhore nuk do ta kufizojë misionin e saj vetëm në periudhën para dhe gjatë zgjedhore, por do të jetë një mekazim shoqëror aktiv gjatë gjithë kohës, duke nxitur pushtetin dhe shoqërinë në procesimin e monitorimit dhe llogaridhënies, si një mekanizëm shumë i nevojshëm për të garantuar pjesëmarrjen e shoqërisë në qeverisje dhe cilësinë e qeverisjes.

Me ndihmën e Fondacionit Soros, Dhoma Zgjedhore ka ngritur një zyrë qendrore si dhe një portal online, në mënyrë që aktorët e shoqërisë civile dhe qytetarët e interesuar mund të kontribuojnë aktivisht për të patur në Shqipëri zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Qëndrimi dhe deklaratimet e Dhomës Zgjedhore mbështeten në informacion që sjellin nga terreni vëzhguesit e organizatave partnere. Përbërja e larmishme e anëtarësimit të saj dhe shumëllojshmëria e informacionit që ato sjellin, krijon mundësinë për analiza të thelluara dhe të balancuara të ngjarjeve që shoqërojnë procesin zgjedhor, rritin besueshmërinë në deklaratimet e vëzhguesve të pavarur, përmirësojnë cilësinë dhe autoritetin e zërit të shoqërisë civile në vlerësimin e zgjedhjeve. Dhoma zgjedhore është komplementare me çdo nismë dhe përpjekje tjetër për monitorimin e zgjedhjeve në Shqipëri.

**Kontakt: Neida Cunaj – Koordinatore e Dhomës Zgjedhore 0693575569
neidacunaj@gmail.com**